

Grupi i punës II ( Drejtësia, Liria dhe Siguria)  
Sesioni 2 & 3: “Sfidat e Migrimit dhe Azilit në Shqipëri”  
11 prill 2016

*Problematika dhe Rekomandime:*

**→ Kapacitetet institucionale në menaxhimin e azilit dhe migrimit**

- Edhe pse Shqipëria deri tani ka pak gjasa që mund të preket nga një fluks i madh refugjatësh, nuk duhet që të lihen pas dore përgatitjet dhe situata e gatishmërisë nëse do të ketë rritje të fluksit të refugjatëve. Kapacitetet dhe autoritetet përgjegjëse duhet të jenë të përgatitura për raste të tilla.
- Edhe pse në qendrat pritëse në Shqipëri sigurohen kushtet minimale të jetesës dhe higjienës, mbetet problematike hapësira për të pranuar shumë refugjatë si dhe mungesa për t’u ofruar kushtet e nevojshme nëse numri rritet në të ardhmen. Gjithashtu duhen plotësuar edhe kërkesa të tjera përveç nevojave minimale siç janë shkollimi, kujdesi shëndetësor, ndihma nga sociologë dhe psikologë, mundësitë për punësim apo trajnime etj.
- Duke qenë që Shqipëria nuk i ka kapacitetet për të pritur një numër shumë të madh refugjatësh, një mundësi është që ajo të kthehet në një vend tranzit. Sipas këtij sugjerimi, personat dhe azilkërkuessit që nuk kanë qëllim final Shqipërinë, mund të qëndrojnë në Shqipëri për një periudhë të shkurtër kohe (jo më shumë se 6 muaj) dhe mund të trajnohen mbi gjuhën e vendit që do të shkojnë. Ky është një proces i ndjekur nga Sllovakia, e cila mbajti ata persona që kishin destinacion final Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke i trajnuar në gjuhën angleze.
- Duhet përforcuar masat për sigurimin e kufijve. Gjithashtu BE planifikon të vendosë ekipe ekspertësh në ato qytete që kanë aeroporte për një proces më efektiv dhe pa shumë kosto.
- Fuqizimi i Drejtorive Lokale të Policisë sidomos të atyre zonave që janë bregdetare apo në kufi. Rritje e patrullimeve dhe stafit.
- Element me rëndësi mbetet regjistrimi i individëve të identifikuar

**→ Kuadri ligjor dhe procedurat e ndërmarra në fushën e migrimit dhe azilit**

- Legjislacioni shqiptar mbi të huajt dhe azilin është i përditësuar dhe deri diku i plotë dhe në harmoni me direktivat e BE-së. Problematike mbetet mosbashkëpunimi me organizatat qeveritare apo grupet e interesit gjatë procesit të hartimit të projektligjeve apo vendimeve të kryeministrit siç është rasti i dy VKM-ve me rëndësi: VKM për miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta dhe vendimi për Komisionin Kombëtar të Azilit dhe Refugjatët.

- Për shkak se legjislacioni evropian dhe direktivat e Komisionit ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme pasi edhe vetë procesi i migracionit të paligjshëm është dinamik, edhe legjislacioni shqiptar duhet të jetë më fleksibël në përshtatjen dhe ndryshimin e tij më shpesh dhe në mënyrë eficiente për të qenë gjithmonë në harmoni me acquis-in e BE-së dhe i përditësuar.
- Fokusi në 'Parimin e Moskthimit', që nënkupton moskthim të refugjatëve në vendin e tyre të origjinës kur ky është i pasigurt, dhe ka rrezik të cenimit të jetës dhe integritetit.
- Krijimi i numrit unik të kartës së identitetit dhe pajisja me leje qëndrimi biometrike janë dy hapa të tjera që duhet të finalizohen në këtë drejtim.
- Dokumentacioni për shtetasit e huaj që futen në Shqipëri në mënyrë ilegale është elementi më i rëndësishëm për të bërë të mundur identifikimin dhe regjistrimin e tyre. Po mundësohet pajisja me letërnjoftim biometrik për të gjitha ata që e kanë siguruar statusin e refugjatit.

### → **Bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm si brenda dhe jashtë vendit**

- Roli i shoqërisë civile në të gjithë procesin e integritetit evropian, por edhe më specifiku mbi këtë situatë është i rëndësishëm dhe element kyç.
- Duhet një bashkërendim i punëve mes autoriteteve si Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policisë kufitare mbi identifikimin dhe përcaktimin e kushteve nga vjen refugjati apo azilkërkuesi. Është mjaft me rëndësi që kthimi i refugjatit të mos bëhet në mënyrë automatike, por të merret parasysh dhe të studiohet çdo rast në mënyrë të detajuar dhe specifike duke kaluar në shumë filtra.
- Ka nevojë për rritje të shkëmbimit të informacionit dhe vendosja e pikave të kontaktit për të parandaluar fluksin migrator. Me rëndësi është që shkëmbimi i informacionit të jetë si strategjik ashtu edhe teknik ku të përfshihet edhe ndihma i BE-së dhe Frontexit.
- Ka një ndryshim pozitiv në realizimin e intervistave dhe formularëve për identifikimin dhe regjistrimin e refugjatëve ku janë shtuar edhe gjuhët e plotësimit të tyre përveç gjuhës Shqipe dhe Angleze, janë futur edhe gjuhë si ajo Arabe, Persiane dhe Pashtu. Gjithsesi për shkak të gamës së gjerë të njerëzve që mund të vijnë është shumë e nevojshme që numri i gjuhëve të shtohet duke përfshirë edhe të tjera. Kjo është pak e vështirë për autoritetet përkatëse, për shkak se këto gjuhë janë të rralla dhe specifike në Shqipëri, kështu që një bashkëpunim më i thellë me shoqërinë civile apo aktorë të tjerë të interesuar mund ta lehtësonin procesin.
- Sugjerohet që të krijohen ekipe të përbashkëta dhe të përziera mes ekspertëve vendas dhe lokal dhe atyre evropian që mund të ndihmojnë me eksperiencën e tyre në problemet teknike dhe logjistike që lindin nga emigracioni i paligjshëm.

- Rritje e partneritetit dhe bashkëpunimit me organizatat jo qeveritare të huaja të atyre vendeve ku qytetarët shqiptarë kërkojnë më shumë për azil apo emigrojnë ilegalisht. Në këtë mënyrë bëhet më e lehtë identifikimi i refugjatëve shqiptarë dhe kërkesave të tyre. Gjithashtu ofrohet ndihma më lehtësisht për këta persona.

### → Ri-integrimi i shtetasve shqiptarë të kthyer

- Problemi i refugjatëve dhe emigrantëve të paligjshëm të shtetit shqiptar drejt BE-së vazhdon të jetë prezent në shumë vende të BE-së. Shteti shqiptar dhe autoritetet duhet të marrin masa për të ulur migracionin e paligjshëm pasi Shqipëria mbetet akoma një nga vendet me numrin më të madh të azilkërkuësve. Masat për të ndryshuar këtë gjë duhet të ndikojnë pozitivisht në rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.
- Nga Komiteti i Helsinkit u parashtrua një çështje problematike që duhet marrë në konsideratë nga institucionet përkatëse, për shtetasit shqiptarë që janë deportuar në vendin tonë. Integrimi i tyre në jetën e përditshme duhet pasur kujdes dhe i duhen marrë masa në mënyrë të menjëhershme. Infrastruktura lë për të dëshiruar.
- Për një mirëmenaxhim të situatës në Pikat e Kalimit Kufitar, institucionet shtetërore mund të kërkojnë bashkëpunim me organizata filantropike, që ti asistojnë me ushqime e veshmbathje.
- Mungojnë të dhënat dhe studimet në lidhje me azilin dhe emigrimin e paligjshëm të shtetasve shqiptarë drejt BE-së. Është rëndësishme të bëhen studime të tilla për të parë situatën dhe masat konkrete që duhen ndërmarrë dhe përgjigjet ndaj situatave që mund të krijohen.
- Informimi mbi të drejtat dhe obligimet që ka refugjati duke përfshirë dhe të drejtën për ankimim në rast se është i pakënaqur me vendimin e marrë nga autoritetet mbi kërkesën e tij për azil.
- Informimi i personave që vijnë në Shqipëri dhe atyre që ikin nga Shqipëria. Në të shumtën e rasteve qytetarët nuk i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat që lejohen dhe ato që nuk lejohen.
- Është i domosdoshëm informimi dhe sensibilizimi i qytetarëve shqiptarë mbi rreziqet nga emigrimi i paligjshëm dhe arsyet, mundësitë dhe procedurat për pranimin ose jo të kërkesës së azilit.

## *Pjesëmarrësit e Sesionit 2 & 3 të Grupit të Punës II : Institucione Shtetërore dhe Shoqëri Civile*

### *Institucione Shtetërore*

#### **Ministria e Punëve të Brendshme në Shqipëri**

Znj. Alma Mele, Drejtorja e Azilit

Z. Ingrid Shkreli

**Ministria e Integrimit European në Shqipëri**– Z. Hektor Dodbiba

**Policia e Shtetit, Drejtorja e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit** – Znj. Enkeleda Toska

### *Delegacioni i BE-së në Shqipëri*

Z. Jan Rudolph, Drejtori i Sektorit Politik, Ekonomik dhe Informativ

Znj. Lisena Gjebrea

Znj. Cristina Alvarez

### *Ekspertët e Grupit të Punës:*

**Lidhja e të Drejtave të Njeriut, Sllovakia**- Znj. Alexandra Marangone

### *Shoqëri Civile:*

UNHCR - Z. Hortenc Balla

**Shërbimet për Migrantët dhe Refugjatët (RMSA)**- Znj. Mariana Hereni

**World Vision in Albania and Kosovo** – Z. Edmond Qotaj

**I Choose to Change the World**- Znj. Greta Çullhaj

**Instituti i Studimeve Politike**- Znj. Jona Karapinjalli

**Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje** - Znj. Romina Malaj

ICMPD- Znj. Tamara Agolli

**Komiteti Shqptar i Helsinkit:**

Znj. Erida Skëndaj,

Znj. Vjollca Meçaj

**Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim:**

Znj. Krisela Hackaj

Znj. Orkidea Xhaferaj

**PAMECA:**

Znj. Marcela Bardho

Znj. Teuta Krasniqi

**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA):**

Z. Gledis Gjipali

Znj. Mona Xhexhaj

Znj. Nirvana Deliu

Znj. Megi Gjoni

Znj. Sajmira Kopani

**Rrjeti i EMA-s:**

Znj. Klodiana Dushaj

Znj. Joana Doda

Z. Albano Roçi

Z. Anton Gurra

Znj. Iva Plaushku

**Media**

ATSH- Z. Arbi Fortuzi

TVSH- Znj. Entela Kemi

Anadolu Agency- Z. Olsi Shehu